

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i Prokurimit : **KEK - 23 - 1746 - 121**

Nri brendshem : **KEKO- 23 - 070 - 121**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me valva te avullit me kontraflanaxha per fryresat e blozes ne kazanin e bl.A3, A4, A5**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**UNIVERS – M SH.P.K.**

*Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj*

*Rruga Eqrem Qabejpn*

*Adresa*

**Millosevë – Obiliq**

**15050**

*Vendi/Kodi postar*

**044 276 071**

*(Numri Telefonit)Numri i Faks-it*

**TEFIK HARGAJA**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**e-mail: univers.m.pr@gmail.com**

*Adresa elektronike*

**Dt.21.08.2023**

*Data e parashtrimt të ankesësNënshkrimi dhe vula*



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

07.03.2023 AK ka bere shpalljen e Njoftimit te Kontrates  
29.03.2023 Afati per dorezimin e tenderit.  
29.03.2023 Procesverbali i hapjes  
13.04.2023 Leter standarde per tenderuesin e eliminuar  
13.04.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK e anulon aktivitetin e prokurimit  
17.04.2023 Kërkesa për Rishqyrtim në AK  
26.04.2023 Pergjigjja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim  
04.08.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK per dhenjen e kontrates  
04.08.2023 Leter standarde per tenderuesin e eliminuar  
09.08.2023 Kërkesa për Rishqyrtim në AK  
14.08.2023 Pergjigjja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim

Kriteri: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Eshte organizuar hapja publike e ofertave ne sistemin e E-prokurimit  
Hapja e ofertave nëmenyre elektronike është bërë me dt.29.03.2023 , nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit.

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 09.08.2023 përmes platformës së e – Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim në AK( Autoriteti Kontraktues) – Korporata energjetike e Kosovës sh.a.

Me datë 14.08.2023 përmes platformës së e – Prokurimit kemi pranuar Pergjigjenen – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues që Kërkesën tonë për Rishqyrtim e konsideron si të pa bazuar.

Të pa kënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues – KEK sh.a , dhe në afatin ligjor e dërgojmë Ankesën në OSHP.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, me rastin e publikimit të njoftimit për Vendimin e dhenjes të kontratës publike për aktivitetin e prokurimit për **Furnizim me valva të avullit me kontrafilanxha për fryresat e blozes në kazanin e bl.A3,A4,A5**, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (me tej: LPP), Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik (me tej: Rrpp), Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik (me tej: Upp), të potencuara si vijon:

- Eshte shkelur neni 1 i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 7 i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 10(5) i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 28 i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 56(1) i LPP-se
- Eshte shkelur neni 59(4) i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 60.1(1.1) i LPP-se,
- Eshte shkelur neni 4.3 (a), (b), (c), (e), (f), (g) i Rrpp,
- Eshte shkelur neni 25.5 (c) i Rrpp,
- Eshte shkelur neni 40.6 (a), (b), (c) i Rrpp,
- Eshte shkelur neni 63 i Rrpp,
- Eshte shkelur neni 97.1(d), (k) i Rrpp,
- Eshte shkelur neni 10.1 lidhur me specifikimet teknike i Upp.



*\*\* Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Fillimisht paraqesim faktet se kompania 'Univers - M' shpk ka bere kerkesen per rishqyrtim ne Autoritetin Kontraktues (AK) me date 03.05.2023 kunder arsyeve te eliminimit te kompanise 'Univers - M' shpk dhe anulimit te ketij aktiviteti i cili eshte konstatuar se ka ndodhur ne shkelje te LPP, Rrpp, Upp nga zyrtaret pergjegjes ne AK. Ky fakt eshte konstatuar me ekspertizen nr.2023/0251 i dates 17.05.2023 te pergaditur nga dy ekspert, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik te autorizuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (Oshp) ku eshte aprovuar ankesa e OE 'Univers - M'. Nga OSHP me pas eshte nxjerrur vendimi nr. 2023/0251 i dates 23.06.2023 me te cilin eshte aprovuar ankesa e OE 'Univers - M' shpk . Ne dispozitiv te vendimit eshte kerkuar AK ne afat prej 10 ditesh te informoje OSHP per veprimet e ndermarra, ku kane kaluar 42 dite deri ne nxjerrjen e vendimit te AK te dates 04.08.2023, ku me vendim propozohet per dhenie te kontrates OE ND shpk i cili edhe pse nuk ka bere asnje ankese, kundershtrim qe nenkupton se me pohimin ne heshtje eshte pajtuar se ka dorezuar oferten e papergjegjshme te konstatuar dhe nenshkuar nga komisioni i vleresimit ne raportin e dates 03.04.2023 i nenshkuar edhe nga dy zyrtare profesional te prokurimit te cilet kane vleresuar dhe konstatuar se OE ND shpk eshte i papergjegjshem per faktin se nuk plotesuar kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate, ndersa per habi me vendim te dates 04.08.2023 e propozojne per dhenie te kontrates OE te cilet zyrtare vete e kane konstatuar se eshte i papergjegjshem.

Kompania 'Univers - M' shpk, ne Kerkesen per Ri-shqyrtim, do te prezentoje faktet permbajtësore per te argumentuar shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues, me daten 04.08. 2023, dergon Njoftimin per Vendim te Autoritetit Kontraktues ne Portalin e E-prokurimit. Kërkesa për rishqyrtim per te dytën here është bërë ne AK me datën 09.08.2023 ndersa vendimi per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim nga AK eshte nxjerrur me datën 14.08.2023.

Nepermjet ketij publikimi, Autoriteti Kontraktues, i ka prezentuar arsyet e dhenjes se tenderit me te cilat nuk pajtohet operatori ekonomik Univers – M shpk.

Operatori ekonomik Univers – M shpk ofronë keto deshmite ne lidhje me dhenjene tenderit:

Operatori Ekonomik UNIVERS – M SH.P.K. pase marrjes se vendimit per dhenje te kontrates me dt.05.08.2023 i jemi drejtuar Autoritetit Kontraktues me një Kerkese per qasje ne dokumentacion e dorezuar nga Operatoret tjere Ekonomik dhe AK me dt. 07.08.2023 na eshte pergjigjur duke na vene ne dispozicion dokumentacionin me qasje te kufizuar te OE tjere pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit: per kompanin: Novamat shpk , RH shpk dhe ND shpk.

Per kompanite Novamat shpk dhe RH shpk më eshte ofruar qasje ne



dokumentacioni tenderues.

Kurse per firmen ND shpk te shpallur fitues kame pasur qasje te kufizuar ne dokumentacion nga zyrtari i prokurimit ne shkelje te nenit 10(5) te LPP-se te cilin konsiderojm se e kane bere per te arsyetuar perzgjedhjen e gabuar qe eshte bere me ofertuesin e papergjegjshem, ku nuk më është ofruar qasje per dokumentacionin sipas nenit 9.1 dhe 9.2 te dosjes se tenderit(bashkangjitur keni Procesverbali per Qasje publike ne dokumentacion nga takimi i mbajtur ne ZEP – KEK-sha dt.07.08.2023)

Ne Seksionin II FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FTD) neni 9.1 & 9.2

Deshmite e kerkuara dokumentare jane:

- 1.Çertifikata(Çertifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001:2015) me te cilen deshmohet se prodhuesi prodhon enet nen presion.
- 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike të vulosura nga prodhuesi i valvave dhe të gjitha pjesëve të valvave , me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.

Dokumentacioni ilarte shenuara nga zyrtari i prokurimit nuk me eshte ofruar me arsyetimin se jane sekret afarist , pasi që Operatori Ekonomik ND shpk. ka plotesuar Aneksi 3 Kerkese per sekret afarist , ku e ka futur nen sekret afarist i **Tërë dokumentacioni i prodhuesit**(bashkangjitur Aneksi 3 i OE ND shpk)

Kjo eshte ne kundërshtim me nenin 10.5 te LPP-se, Ligjit per qasje ne dokumentet publike, per arsye se certifikata ISO 9001:2015 eshte dokument publik dhe nuk ka asnje element qe mund te konsiderohet si sekret te cilin vleresim duhet te beje Autoriteti Kontraktues. Certifikata ISO 9001:2015 leshohet nga organet kompetente te specializuara te pavarura dhe mbajtja si sekret e ketij dokumenti eshte ne shkelje te LPP-se dhe Ligjit per qasje ne dokumentet publik , Katalogu i prodhuesit nuk eshte dokument sekret pasi qe katalogu eshte dokument publik , e pasi qe ketu kemi te bejme me shpenzim te parase publike te cilat para i perkasin Qytetareve dhe kane te drejte te din ku behet shpenzimi i parase publike, per me teper per nje OE qe eshte i papergjegjshem i cilli ka pranaur me pohimin ne heshtje pa asnje ankese, kundërshtim kur eshte eliminuar i papaergjegjshem nga AK.

Duhet potencuar se ne raportin e vleresimit dt.03.04.2023 (bashkangjitur keni raportin e vleresimit) dhe Njoftimin mbi vendimin e AK permes platformes elektronike te dt.13.04.2023 ku AK – KEK sha e anulon aktivitetin e prokurimit per arsye se te gjithë OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit jane te pa pergjegjshem , vetem OE UNIVERS – M SHPK. i pa knaqr me vendimin e AK ka parashtruar Ankese ne OSHP dhe eshte nxjerrur vendimi 2023/0251 dt.23.06.2023 ne kete vendim ankesa e jone Aprovohet si e bazuar.

Dhe me Njoftimin mbi vendimin e AK te dt.04.08.2023 dhe sipas raportit te **Rivlersimit** te dt.14.07.2023 (bashkangjitur keni raportin e rivleresimit) kompania UNIVERS – M SHPK eshte oferte e pergjegjshme dhe i ka plotesuar te gjitha kerkesat ne dosjen e tenderit por nuk eshte oferte me çmimin me te ulët.



Gjate kontrollimit te dokumentacionit te marrur ne ZEP dt.07.08.2023 per qasje ne dokumentacion ne **raportin e vleresimit te dt.03.04.2023** kemi konstatuar kete shkelje ligjore:

Ne Letren standarde per tenderuesin e eliminuar per operatorin ekonomik ND shpk dhe RH shpk te dt.12.04.2023 dhe ne **raportin e komisionit vleresues te dt.03.04.2023 Ekzaminimi , vleresimi dhe krahasimi i tendereve lidhur me aftesine teknike dhe / ose profesionale** ka moseperputhje ne pershkrimin e anulimit – nuk eshte pershkrimi i njejte per arsyet e anulimit :

Nga raporti i vleresimit - komisioni vleresues i dt.03.04.2023 perpos mangesive tjera te anulimit ne raport e ka cekur se OE ND shpk dhe RH shpk ne **Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme nuk është plotësuar rubrika: Pjeset e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi, pra nuk eshte plotësuar aneksi 1 i specifikimeve teknike te detyrueshme siç eshte kerkuar nga AK ne dosjen e tenderit.**

Kurse ne publikimin nga zyrtari pergjegjes i prokurimit (ZPP)ne Letren standarde per tenderuesin e eliminuar te dt.12.04.2023 per operatorin ekonomik ND shpk dhe RH shpk( bashkangjitur Letrat standarde) ne anulim nuk është cekur hiq se:ne **Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme nuk është plotësuar rubrika: Pjeset e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi, edhe pse i njeiti ka nenshkruar dhe aprovuar raportin e vleresimit te dates 03.04.2023.**

Nese nga Operatoret Ekonomik ofertues ne kete aktivitet te prokurimit nuk plotesohet: **Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme ne rubrikat ku eshte kerkuar te plotesohen rubrikat:Pjeset e ofruara nga OE , Produkti i Ofertuar dhe Prodhuesi** ashtu siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit , **tenderi refuzohet pa kerkuar informacion te mëtejshëm, ( bashkangjitur gjeni udhezuesin Nr.001/2023 per prokurimin publik - KRPP)**, nga kjo vertetohet se OE ND shpk edhe heren e pare ka qene ofertues i papergjegjshem dhe nuk ka bere asnje ankese ne lidhje me eliminim si ofertues i pa pergjegjshem dhe per habi pasi qe lenda kthehet ne **rivlersim** komisioni **rivlersues i dt.14.07.2023** nuk i merr parasysh keto mangesi dhe ne verejtjet permbyllese ne lidhje me vleresimin e tendereve te pergjegjshem konstaton se vetem dy oferta i plotesojne te gjitha kerkesat ne dosjen e tenderit dhe komisioni i vleresimit propozon qe oferta e operatorit ekonomik ND shpk si oferte me e lire dhe e pergjegjshme te **shperblehet me kontrate.**

Kur kesaj i shtohet fakti se gjate verifikimit te dokumenteve per qasje publike te marrura ne ZEP, OE ND shpk dhe RH shpk. kane ofertuer me te njeitin prodhues Modus Micevskidoool Shkup –Maqedoni dhe ne Letren standarde per tenderuesin e eliminuar te dt.04.08.2023 per firmen **RH shpk** ne anulim eshte e cekur se:

**Ka vetem vizatimin dhe pershkrimin nga AK – KEK-u te vertetuar , por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me prerje terthore nga prodhuesi siq eshte kerkuar ne nenin 9.1dhe 9.2 ne FDT te DT dhe per keto arsye kemi dyshime te bazuara per OE ND shpk. te shpallur fitues nga AK i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, siq eshte kerkuar ne nenin 9.1dhe 9.2 ne FDT te DT pasi qe dokumentet e prodhuesit per firmen ND shpk nuk mu kane ofruar nga zyrtari i prokurimit, dhe eshte nga i njeiti prodhues qe dorezohen dy**



oferta nga dy OE, ku ne njeren oferte te OE RH shpk eshte konstatuar i papergjegjshem sepse i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, dhe logjikisht i mungojn edhe te OE ND shpk, sepse si ka mundesi nga i njejti prodhues ne njeren oferte mos te plotesoj kerkesat e dosjes se tenderit ndersa ne tjetren oferte te OE ND shpk shpalet fitues dhe neve na pamundesohet qasja ne dokumente sipas nenin 9.1 dhe 9.2 te dosjes se tenderit: *Dëshmia e kërkuar dokumentare per piken 1 dhe piken 2 .*

Dyshimet tona ne lidhje me dokumentacionin e prodhuesit per firmen ND shpk do te kerkojme qe te verifikohen gjate fazave te ankesave sepse dyshojme qe nuk i ploteson kerkesat e dosjes se tenderit , ku shihet nga kronologjia dhe lidhmeria e fakteve, provave nje nga nje nga vleresimi i pare deri te vleresimi i dyte, pranimi i pohimit ne heshtje se ka dorezuar oferten e papergjegjshme OE ND shpk pa asnje ankese, kundërshtim kur eshte eliminuar nga AK.

Per me teper deklarata nen betim dhe dokumentet tjera te neshkruar nga OE ND shpk nuk jane nenshkruar nga pronari ose perfaqesuesi i autorizuar ne formularin e regjistrimit me numer unik identifikues ne Agjencine regjistrimeve te bizneseve, dhe edhe per kete fakt eshte i papergjegjshem, sepse nuk mund te nenshkruaj dokumenti personi i paautorizuar ne emer te kompanise, i cili per me teper ka te paraqitur numrin e punetoreve 1 (nje) ne Arbk, dhe nuk mund te bartet përgjegjësia ligjore nga pronari i kompanisë te nje person i cili sipas regjistrimit ne Arbk nuk eshte as punëtor i kompanise.

Pergjigjet e OE Univers – M shpk ne pergjigjet e AK sipas pikave te renditura:

1.OE Ankues eshte thirrur ne komisionin paraprak dhe ne vendimin e OSHP-se nr. 2023/0251 dt.23.06.2023 sepse behet fjale per te njejtin projekt, kjo behet me qellim qe te mos respektohet vendimi i OSHP-se, dhe veprimet e parregullta per tu mbuluar nga Autoriteti Kontraktues, madje nje zyrtar eshte caktuar dy here ne komisionet e vlerësimit, edhe ne komisionin e pare te vlerësimit, edhe ne komisionin e dyte te rivlerësimit qe konsiderojmë se eshte veprim i parregullt nga AK.

2.OE Ankues ka pasur qasje te kufizuar per pikat e cekura ne Procesverbal te dt.07.08.2023((bashkangjitur Procesverbali per Qasje publike ne dokumentacion nga takimi i mbajtur ne ZEP –KEK-sha dt.07.08.2023). Kjo ka te beje sepse nuk eshte dhene qasje ne Katalogun e prodhuesit dhe Çertifikaten ISO 9001:2015 te prodhuesit qe nuk jane dokument sekret pasi qe ISO 9001:2015 dhe Katalogu eshte dokument publik.

3. OE Ankues ne Kerkesen per Rishqyrtim te dt.09.08.2023 ka cekur:  
Kur kesaj i shtohet fakti se gjate verifikimit te dokumenteve per qasje publike te marrura ne ZEP, OE ND shpk dhe RH shpk. kane ofertuer me te njejtin prodhues Modus Micevski dooel Shkup – Maqedoni dhe ne Letren standarde per tenderuesin e eliminuar te dt.04.08.2023 per firmen **RH shpk** ne anulim eshte e cekur se:

**Ka vetem vizatimin dhe pershkrimin nga AK – KEK-u te vertetuar , por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me prerje terthore nga prodhuesi siq eshte kerkuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 ne FDT te DT dhe per keto arsye kemi dyshime te bazuara per OE ND shpk. te shpallur fitues nga AK i mungon katalogu i**



prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, siq eshte kerkuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 ne FDT te DT pasi qe dokumentet e prodhuesit per firmen ND shpk nuk mu kane ofruar nga zyrtari i prokurimit, dhe eshte nga i njeiti prodhues qe dorezohen dy oferta nga dy OE, ku ne njeren oferte te OE RH shpk eshte konstatuar i papergjegjshem sepse i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, dhe logjikisht i mungojn edhe te OE ND shpk, sepse si ka mundesi nga i njeiti prodhues ne njeren oferte mos te plotesoj kerkesat e DT ndersa ne tjetren oferte te OE ND shpk shpalet fitues dhe neve na pamundesohet qasja ne keto dokumente.

**Kërkojmë nga OSHP-ja të verifikohen dokumentet e poshtë shënuara pasi që këto dokumente nuk më janë dorëzuar nga zyrtari i prokurimit në Kërkesën tonë për qasje në dokumente:**

Ne Seksionin II FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FTD) neni 9.1 & 9.2 Deshmite e kerkuara dokumentare jane:

- 1.Çertifikata(Çertifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001:2015) me te cilendeshmohet se prodhuesi prodhon enet nen presion.
- 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike të vulosura nga prodhuesi i valvave dhe të gjitha pjesëve të valvave , me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni

Pasi që OE ND shpk i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me prodhues nga Maqedonia kerkojme te verifikohet edhe gjuha e dokumenteve te dorezuara nga OE i rekomanduar per kontrate , **pasi qe gjuha zyrtare ne dokumentacion tenderues duhet te jete ne gjuhen shqipe , angleze dhe gjuhen serbe.**

4. OE Ankues Univers – M shpk **nuk** eshte thirrur qe OE i rekomanduar per kontrate ka vetem vizatimet e AK – KEK sha dhe nuk ka te dorezuar katalog te prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit pasi qe keto dokumente sipas nenit 9.1 dhe 9.2 **nuk** na jane ofruar nga zyrtari i prokurimit OE ankues i ka dyshimet pasi qe dy ofertues ND shpk dhe RH shpk kane ofertuar me te njeitin prodhues: Modus Micevski dooel Shkup – Maqedoni dhe komisioni i Rivleresimit me dt.14.07.2023 në

Letren standarde per tenderuesin e eliminuar te dt.04.08.2023 per firmen **RH shpk** ne anulim eshte e cekur se:

Ka vetem vizatimin dhe pershkrimin nga AK – KEK-u te vertetuar , por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me dimensione dhe prerje terthore nga prodhuesi siq eshte kerkuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 ne FDT te DT( **bashkangjitur Letren standarde per tenderuesin e eliminuar RH shpk.**)

5. OE ankues eshte thirrur qe nuk eshte plotesuar Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme rubrika: **Pjeset e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi**, pra nuk eshte plotesuar aneksi 1 i specifikimeve teknike te detyrueshme siq eshte kerkuar nga AK ne dosjen e tenderit.( **bashkangjitur Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme i pa plotesuar ne rubrikat e kerkuara ne DT nga firma ND shpk.**) AK eshte thirrur se OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar Deklaraten per specifikacionet teknike per mallrat e ofruara te cilat perputhen me ato te permendura ne Aneksin 1 Specifikimet teknike te



detyrueshme te dosjes se tenderit - Neni 3.1 ku shihet qarte qe OE ND shpk i rekomanduar per kontrate **nuk** e ka te plotesuar Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme ne rubrikat : **Pjeset e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi**

**Nese OE nuk e ka të plotësuar specifikimin teknik per mallrat e ofruara ashtu siq është kërkuar në dosjen e tenderit , tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm ( bashkangjitur gjeni udhezuesin Nr.001/2023 për prokurimin publik - KRPP faqe 41 dhe faqe 42)**

*6. AK thirret ne Deklaraten nen betime cila nuk është plotësuar nga pronari i kompanisë (kompania në regjistrin e regjistruar ne Arbk ka nje punëtor) te cilën deklarate duhet te neshkruaj pronari i kompanisë per te marre obligime dhe përgjegjësi ligjore e jo personi qe sipas regjistrit ne Arbk nuk eshte as punëtor i kompanisë.*

Kërkesa për rishqyrtim trajtohet nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit sipas nenit 63 të Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik e jo nga komisioni vlerësues apo rivlerësues siq është shënuar në vendimin e datës 14.08.2023 sepse për këtë: Komisioni vlerësues apo rivlerësues nuk ka as autorizim ligjor, as kompetencë për të trajtuar kërkesën per rishqyrtim dhe rrjedhimisht vendimi i datës 14.08.2023 është pa efekt juridik, dhe trajtimi i bërë është nga komisioni vlerësues – rivlerësuar, që nuk kanë as autorizim ligjor nga ligjvënësi as kompetencë për të trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

### **PROPOZIM**

**Duke marre parasysh argumentet, faktet, provat e potencuara dhe arsyetimet e ofruara me arsyetim ligjor dhe pretendimet per dipozitat ligjore te specifikuara ne piken 7 te kesaj ankesë dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues,Kompania 'Univers - M', sh.p.k i propozon Organit Shqyrtues te Prokurimit Publik:**

- te aprovoje ankesen e OE "Univers – M" sh.p.k. si te bazuar,
- te anuloje vendimin e AK te datës 14.08.2023 si jo te ligjshem, dhe
- lenden e kontestuar te ktheje ne RI-VLERESIM te ofertave duke propozuar per dhenie te kontrates oferten e pergjegjshme me çmimin me te ulet e cila ploteson kerkesat, kriteret e dosjes se tenderit sipas rregullave te prokurimit publik, per te cilën AK nuk ka respektuar edhe vendimin OSHP: 2023/0251.

### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale janë të konsiderueshme në fushen financiare rreth pregaditjes se dosjes tendereuese , garancioni i ofertes , vazhdimin e garancionit te ofertes , fitime te munguara, mos mundesi te kompenzimeve te ketyre shpenzimeve pergaditore, dhe kontratës se humbur.

### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

01.Datë 07.03.2023 "Njoftimit për Kontratë"

02.Datë 29.03.2023 Procesverbali i hapjes se tenderit

03.Datë 13.04.2023 Leter standarde per tenderuesin e eliminuar



- 04.Datë 13.04.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK e anulon aktivitetin e prokurimit
- 05.Datë 17.04.2023 Kërkesa për Rishqyrtim në AK
- 06.Datë 26.04.2023 Pergjigjja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim
- 07.Datë Njoftimi mbi vendimin e AK per dhenjen e kontrates
- 08.Datë 04.08.2023 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar
- 09.Vendimi i OSHP-se nr. 2023/0251 dt.23.06.2023
10. Kërkesen për qasje në dokumente publike dt.05.08.2023
- 11.Procesverbal i për qasje në dokumentacion në ZEP – KEK shp dt.07.08.2023
- 12.Raporti i vleresimit - komisionit vlerësues i dt.03.04.2023
13. Raporti i Ri- vleresimit - komisionit ri- vlerësues i dt.14.07.2023
- 14.Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme të plotësuar në rubrikat e kërkuara në DT nga firma ND shpk.
- 15.Udhezues Nr.001/2023 për prokurimin publik - KRPP
- 16.Aneksi 3 Kërkesa për sekret afarist i firmës ND shp.
- 17.Kërkesa për Rishqyrtim në AK dt.09.08.2023
- 18.Prrgjigja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim me nr.5279 dt.14.08.2023
- 19.Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me neni 118 të LPP,
- 20.Të gjitha korrespondencat me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

Verejtje: Te gjitha pretendimet tona tona mbështeten në fakte bashkangjitur ankesës , materialin e të gjithë tenderueseve e gjeni në procedurën e prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit në Autoritetin Kontraktues – Korporatën Energjetike të Kosovës sh.a.